



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-3656**

**Pejë, datë: 20 Janar 2022**



**PROCESVERBAL**

Nga takimi i I-rë i Komitetit për Politikë e Financa i KK Pejë, mbajtur me 20 Janar 2022, në ora 10:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryetari z. Gazmend Muhaxheri, Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorin të Kuvendit, znj. Mire Mujaj Asistente Administrative e Kryesuesit, dhe përfaqësuesit e ZIP.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se jemi të gjithë anëtarët prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin për rendin e ditës, ku i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendos në rend dite.

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: se e kemi si material shtesë që ju kemi percjell në email gjithashtu këtë material shtesë e kemi të inkorporuar në rendin e ditës që ju kemi sjellë para jushë, këtë material shtesë nuk kemi mundur me ju dergu me kohë për shkak të konstituimit të organeve komunale.

Unanimisht nga të gjithë prezent u miratu ky:

## RËND DITE

- 1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**
- 2. Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoritë e SHCK:**
  - 2.1. Shqyrtimi i Draft: Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës Pejë, për vitin 2022.
  - 2.2. Shqyrtimi i Draft – Planit të punës së Kuvendit të Komunës Pejë për vitin 2022.
  - 2.3. Shqyrtimi i Draft – Planifikimit përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022.
  - 2.4. Shqyrtimi i Planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2020.
  - 2.5. Informatë e kryetarit të Komunës për gjendjen ekonomiko – financiare të Komunës.
  - 2.6. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedruave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
  - 2.7. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënjes në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
  - 2.8. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPT. “Stacioni i Autobusave” sh.a. Pejë.
  - 2.9. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë.
  - 2.10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “EKO - SIG” sh.a. Pejë.
- 3. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.**

## I.

### **Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk pat.

## II.

### **Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK-së:**

#### **2.1. Shqyrtimi i Draft: Kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës Pejë, për vitin 2022.**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: këto kalendare duhet të jenë të harmonizuar më kohë, sëpaku 7 dit pune para takimeve, në maerial e keni orarin e takimeve të KPF-së dhe takimeve të kuvendit, mirëpo nuk do të thotë se këto data nuk mund të ndryshohen varësisht nga ndonjë ngjarje apo event të caktuar.

Dr. Dritë Lokaj Maloku: me rendësi është punuar ky orarë i cili pastaj mund të ndryshohet në bazë të datave të caktuara.

Unanimishtë u votua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim draft kalendarit të takimeve të Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës Pejë, për vitin 2022.

#### **2.2. Shqyrtimi i Draft – Planit të punës së Kuvendit të Komunës Pejë për vitin 2022.**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: edhe draft plani i punës së kuvendit ka lidhshmëri me piken e parë, nese nuk ka dikush diqka me shtu atëher e hedhim në votim.

Unanimishtë u votua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim draft planit i punës së Kuvendit të Komunës Pejë për vitin 2022.

### **2.3. Shqyrtimi i Draft – Planifikimit përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022.**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: siq shihet ky planë duhet të jetë i përfunduar me ato projekte kapitale të cilat janë paraparë për vitin 2022, materialin e keni që është përgaditur nga zyra e Prokurimit, nese keni ndonjë pyetje kryetari mund të ju shpejtoj. Me tutje kryesuesi shtoj se kjo pikë shkon në kuvend si informatë.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: ky draft planë është informative që duhet me qenë i publikuar që me ditë edhe operatorët ekonomik se qka ka me u punu Brenda këtij viti.

z. Labinot Panxha: a mundet me ndryshu ky plan?.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri; mundet me ndryshu me projekte të MAPL-së dhe me projekte që i kemi me donator, me fondet IPA dhe caritasin Zvicran, pra mundet me u shtu po këto pika nuk llogariten që janë në këtë plan, sepse kjo vlersohet, nese i kemi 81 na mundem me i pas 4% planifikime që janë të papaparara, përndryshe jo sepse marrim poena negative sepse jemi në garën e USAID-it.

Unanimishtë u votua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim si pik informative draft plani Planifikimit përfundimtar të Prokurimit për vitin 2022.

### **2.4. Shqyrtimi i Planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2020.**

Dr. Zize Hakaj Veselaj: këtu shihet se auditori i ka renditë 14 të gjetura, të cilat janë në kundërshtim me ligjin në fuqi, e gjetura e parë të thirrja publike për subvencione e cila është në kundërshtim me rregulloren gjegjëse (e lexon tekstualishtë këtë të gjetur të auditorit); pastaj e gjetura tjetër të mungesa e projekteve ekzekutive; vonesa në pagesat e faturave të pa paguara; mungesa e bazës së dhënave të tatimit në pronë; verifikimi i gjëndjes aktuale të pronave; shpërblimi me kontrata pa i plotësuar kërkesat e dosjës së tenderit; investime publike në parcelat e pa shpronsuara, kështu me radhe znj. Veselaj i permendi edhe disa të

gjetura, mirpo theksoi ajo se aty thuhet se zbatimi fillon menjëher, a ka fillu zbatimi i këtyre rekomandimeve?.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: po ka filluar ky zbatim i rekomandimeve të disa të gjetura, por këtë plan na duhet me qu në asamble me i njoftu se kemi fillu me i zbatu këto rekomandime sepse është obligim ligjor, ky planë është më i miri në Kosovë sepse nuk ka kualifikim të qështjes; të këto 14 gjetje nëse vazhdon projekti i USAID-it na ish dashtë me i adresu 75% të këtyre të gjeturave.

z. Labinot Panxha: zakonisht kryetari thirret se komuna është kampion në këtë drejtim, ama nuk mundesh me qenë kampion me këto 14 të gjetura, sidomos të lëshimi i procedurave e që tregojnë një mungesë serioziteti në punë, mendoj që duhet me patur kujdes të zbatimi i procedurave, ndërsa të rruget e asfaltuara duhet me patur kujdes që mos me hy me jau shtru edhe oborret e me bo shpenzime të panevojshme.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: është mirë që me lexu raportin e monitorimit 5 vjeçar të USAID-it, ajo është meritore që me i vlersu monitorimin e komunave, si dhe raportin e performancës nga MAPL me DEMOS-in Zvicran.

z. Berat Ganiqi: të shpronsimet duhet kryen pagesat, edhe të mospagimi i faturave me koha komuna mund të hy në disa obligime që mundet me u dërgu të përmbaruesi privat, sepse aty ka taksa shtes dhe dalim në humbje; edhe te mbledhja e llogarive të arkëtushme, sidomos të tatimet thirren të përmbaruesi privat, duhet me ditë se qfar lande dërgohet të përmbaruesi sepse mund të bëhët edhe parashkrimi i borxhit, ka njerz që nuk kanë paguar që 10 vite dhe ti nuk mundësh me jau marrë tatimin në pronë.

Unanimshtë u votua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim si pik informative shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit 2020.

## **2.5. Informatë e kryetarit të Komunës për gjendjen ekonomiko – financiare të Komunës.**

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: këtë pikë e prezantoj në seancë nese pajtoheni.

Unanimishtë u votua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim si pik informative informatë e kryetarit të Komunës për gjendjen ekonomiko – financiare të Komunës.

## **2.6. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedruave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: siq e dini në seancën e kaluar e kemi aprovu listen e pronave publike të cilat mund të ipën në shfrytëzim për këtë vit, tani e kemi formimin e komisionit vlersues që përbëhet nga 2 anëtar nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile, gjithsejtë 5 anëtar, materialin që e keni marrë jan emrat që i ka propozu kryetari nga ekzekutivi, në na mbetën që dy anëtar ti zgjedhim në kuvend.

z. Labinot Panxha: duke pas parayshë që drejtoret janë nga ekzekutivi, mendoj që dy anëtarët e kuvendit kish qenë mire që me ju taku partive opozitare, neve dhe LVV-së, dërsa ndoshat ai i shoqeris civile përzihet me juve.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: unë e kam vullnetin që me ju jep edhe anëtarët e kuvendit në këtë komision si dhe edhe atë të shoqërisë civile merrne dikond të juajin.

Unanimishte u aprovua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim formimi i komisionit vlerësues për zbatimin e procedruave të dhënjës në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

**2.7. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënjes në Shfrytëzim afatshkutër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.**

Unanimishte u aprovua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim formimi i komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënjes në shfrytëzim afatshkutër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

**2.8. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “Stacioni i Autobusave” sh.a. Pejë.**

Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj: për cdo mandat të ri duhet emrohen komisionet aksionere të NPL-ve, një anëtar propozohet nga ekzekutivi, ndërsa dy anëtarët tjerë të kuvendit, konkluzionet i keni në material, edhe për këtë pikë si dhe për dy komisionet tjera të aksionerve të NPL-ve.

Unanimishte u aprovua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim zgjedhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “Stacioni i Autobusave” sh.a. Pejë

**2.9. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë.**

Unanimishte u aprovua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim zgjedhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “Ambienti” sh.a. Pejë.

**2.10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “EKO - SIG” sh.a. Pejë.**

Unanimishte u aprovua që ti rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim zgjedhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL. “EKO - SIG” sh.a. Pejë.

### **3. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar.**

1. z. Berat Ganiqi: qka po ndodh me këto parkingje sepse në seancë that që në prill 2021 ju ka skadu afati, ndërsa ata po vazhdojnë me i tatimu qytetarët?

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: po jau kemi zgjatë sepse ne kontrat u ka qenë e parapar kjo në raste të nevojshme edhe me kërkesë të policisë që mos me u bo kaos deri në proceduren e prokurimit që përfundon me ju jap dikujt tjetër.

2. Labinot Panxha: për parkingjet e reja nuk ka kontrat apo?.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: në kontrat e ka numrin e parkingjeve sa i rritet sa i zvoglohet, prej komisionit të partise juaj që ka qenë në pushtet, unë nuk kam mujt me prish kontratën e pastaj me hy në obligim shtesë.

3. Berat Ganiqi: mos kish qenë më mirë me themelu një kompani lokale dhe me u marrë me këtë qështje.

Kryetari z. Gazmend Muhaxheri: problemi është se të hyret nuk mundesh me i menaxhu se ndryshe e kontrollon privati, sepse aty po duhet me ju marrë paret në dor njerzve, zakonishtë janë dal minus kur i ka menaxhu komuna këto parkingje.

Dr. Zize Hakaj Veselaj: numri i rasteve me covid 19 veq ka fillu me u rritë, kish qenë mirë me qel prap aneksin, sepse po na bjen me trajtu në të njejten dhom pacientin me covid dhe atë pa covid, si dhe kish qenë mirë mos me na mungu gjërat elementare.

Dr. Myrvete Salihu: na jemi në bashkërendim me spitalin, ne aneksin e kemi hap, ne kemi mbajtur një takim edhe me drejtorat e shkollave dhe me shefat. Ndërsa për barrna esenciale ti e din qka kemi, tjerat janë barrë e MSH-së.





